

SHKALLËT E BESIMTARËVE NË RRUGËTIMIN DREJT ALLAHUT (MEDAARIXH ES-SAALIIN)

Mirënjohja / *esh-Shukr* / الشُّكْرُ

Dr. Hatim el-Haxh

Materiali është përmbledhje e kuptimeve të audio-ligjëratës nga nxënësit e hoxhës

<https://buff.ly/2hbVv4T>

Allahu ﷻ thotë:

"وَقَلِيلٌ مِّنْ عِبَادِيَ الشَّاكِرُونَ"

“Pak prej robërve të Mi janë mirënjohës.” (Sebe’, 13)

Mirënjohja i referohet njohjes së mirësive, meqë kjo është mënyra për ta njohur dhuruesin e tyre. Nga ky shkak, Allahu i plotfuqishëm i referohet Islamit dhe *imanit* në Kuran si mirënjohje.

Ka tri kuptime të mirënjohjes: njohja e mirësive, pranimi i tyre, dhe në fund lavdërimi i Dhuruesit të tyre¹. Kjo gjendje ende ka të bëjë me shtegun e besimtarëve të rëndomtë² dhe ndahet në tri nivele:

Niveli i parë: Shfaqja e mirënjohjes për të dëshirueshmet. Në këtë lloj marrin pjesë muslimanët, çifutët, të krishterët, dhe zoroastrianët (mexhusët). Është nga mëshira e pamasë e Tij që ta konsiderojë këtë si mirënjohje dhe të

¹ Imam Ibn el-Kajjim përmend në *el-Medaarixh* se mirënjohja apo falënderimi qëndron në pesë baza: nënshtrimin ndaj të falënderuarit, dashurinë ndaj Tij, pranimin e favoreve të Tij, lavdërimin e Tij, dhe përdorimin vetëm të asaj që Ai pëlqen.

² Sepse, sipas pikëpamjes së shejhut (el-Harawi), asnjë nga shkallët ku nuk arrihet vetasgjësimi (shpërbërja e egos) nuk i ka hije elitës së besimtarëve. Kur personi të arrijë vetasgjësimin (*fanaa*), të gjitha ndjenjat do t'i ketë të shuara, në mënyrë që s'do të bëjë më dallim mes mirësive dhe fatkeqësive. Siç kemi thënë më herët, vetasgjësimi i miratuar nga sheriatu nuk lyp zhdukje të plotë të egos - gjë që është edhe e pamundshme – por lyp përputhje apo përshtatje me vullnetin e Zotit. Kjo ego, me gjithë respektin e thellë ndaj madhështisë së Tij, nuk do të shpërqendrohet nga përshtatja me urdhrat dhe vullnetin e Tij. Për më shumë, shkalla e mirënjohjes është shkalla e ajkës së elitës së besimtarëve të të gjitha kohëve – peygamberëve të Allahut. Allahu tha për Nuhun ﷺ: “Vërtet, ai qe një rob mirënjohës” (el-Isra, 3); për Ibrahimin ﷺ: “(Ai qe) mirënjohës për favoret e Tij” (en-Nahl, 121); dhe Ai i tha Muhamedit ﷺ “Adhuro (vetëm) Allahun dhe ji ndër mirënjohësit” (ez-Zumer, 66), i cili i tha Aishes, kur ajo pyeti përse ai po falte namaz derisa i çaheshin shputat: “A të mos jem një rob mirënjohës (ndaj Allahut)?”

premtojë më shumë mirësi si dhuratë, duke e bërë këtë të denjë për shpërblim.

Niveli i dytë: Shfaqja e mirënjohjes në telashe. Këtë e shfaq një nga dy personat: ai për të cilin të gjitha situatat janë të njëjta, çka nënkupton shfaqjen e kënaqësisë; ai që dallon situatat dhe ndrydh zemërimin, fsheh ankimin, tregon mirësjellje (ndaj Zotit), dhe përshtatet me dijen (e shpallur). Këta mirënjohës janë të parët që do të ftohen për të hyrë në xhenet.

Niveli i tretë: Kjo është kur robi nuk sheh gjë tjetër veç Dhuruesit të mirësive, në mënyrë që, kur e bën këtë nga pozita e robërimit, shton shpërblimin; kur e bën nga pozita e dashurisë, gjen ëmbëlsi në vështirësinë e caktuar nga Ai; kur e bën nga pozita e njohjes së njësisë së Tij (*tefriid*), nuk njuh ndonjë çmim apo vështirësi.³

³ Sepse të gjitha gjërat janë nga i Vetmi (i lartësuar qoftë!). Ndonëse të gjitha gjërat janë nga i Vetmi – dhe nga kjo pikëpamje s'mund të përshkruhen si të këqija, sepse plani i Tij gjithëpërfshirës ka të bëjë me mirësi – ato ende janë të ndryshme nga këndvështrimi ynë; besimi dhe mosbesimi, dëgjueshmëria dhe gjynahu, drejtësia dhe padrejtësia, virtyti dhe vesi – të gjitha ekzistojnë në këtë botë, janë të ndryshme dhe nuk bën të shpërfillen. Kjo është *el-Ferk* (dallimi i shumësisë së gjërave të kësaj bote) që duhet të shihet me *xhem'* (bashkim apo shoqërim me Zotin, të Vetmin, shkakun e parë) në të gjitha kohët, në mënyrë që të arrihet realizimi i përshtatshëm i kërkesave të Tij ndaj nesh.